



Me qëllim implementimin e aktiviteteve të parashikuara me Programin për aktivitetet nga fusha e mbrojtjes sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore, në qytetin e Shkupit për vitin 2022 ("Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit" numër 16/21), Qyteti i Shkupit shpall

THIRRJE PUBLIKE
për përkrahje të projekteve dhe aktiviteteve programore të organizatave që
veprojnë në fushën e mbrojtjes sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore

Lënda e Thirrjes publike është mbledhja e ofertave për përkrahje financiare të projekteve dhe aktiviteteve programore (projekte) të shoqatave civile, fondacioneve dhe subjekteve të tjera (organizata) që veprojnë në fushën e mbrojtjes sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore.

Projektet dhe aktivitetet programore do jenë të përkrahura me mjete nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2022, dhe në përputhje me Programin për aktivitete në fushën e mbrojtjes sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore në qytetin e Shkupit për vitin 2022 (Program) si dhe në bazë të kriterëve dhe prioriteteve të dhëna në këtë Thirrje publike.

I. Përshkrim i shkurtër i Programit dhe llojeve të projekteve të cilat do të përkrahen:

Në suazat e Thirrjes publike, projektet që do të përkrahen me mjete financiare nga ana e Qytetit të Shkupit, duhet të kenë lidhje me Prioritetet, e definuara në Programin për aktivitetet nga fusha e mbrojtjes sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore, në qytetin e Shkupit për vitin 2022 (Programi është në dispozicion në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk) dhe atë:

1. Realizimi i mbrojtjes sociale të personave me nevoja të veçanta;
2. Realizimi i mbrojtjes sociale të personave që përdorin droga;
3. Përfshirja shoqërore dhe shërbime sociale për kategoritë në nevojë të qytetarëve;
4. Mundësi të njëjta të grave dhe burrave, mos diskriminim, nxitje dhe zhvillim i vlerave personale dhe shoqërore;
5. Avancimi i mbrojtjes shëndetësore.

II. Korniza kohore dhe shfrytëzimi i mjeteve

Mënyra e shfrytëzimit të mjeteve për vitin 2022 do të specifikohet në kontratën ndërmjet organizatës dhe Qytetit të Shkupit.

III. Kriteret themelore

Kriteret themelore të cilat duhet t'i plotësojnë Organizatat, shoqatat të cilat marrin pjesë në këtë Thirrje publike janë:

- Të jenë të regjistruar sipas Regjistrimit qendror të RM;
- Të merren me aktivitete dhe projekte të interesit publik për minimum dy vite;

IV. Dokumentacioni i obligueshëm për aplikim

- Fletëparaqitje për përkrahje financiare të Organizatës, të nënshkruara dhe të vërtetuar me vulë nga personi i autorizuar;
- Formular i plotësuar për propozim – projektin;
- Statut i Organizatës;
- Aktvendimi për regjistrimin e Organizatës;
- Raport për mjetet e fituara nga Buxheti i Qytetit të Shkupit në vitin e kaluar fiskal dhe mënyrën e realizimit të tyre (nëse organizata ka qenë shfrytëzues i mjeteve të ndara nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2021);
- Fotokopje nga llogaria përfundimtare për vitin 2020;
- Vërtetim për pagimin e tatimeve të nxjerë nga organet tatimore.

VËREJTJE: Fletëparaqitjet të cilat nuk përmbajnë dokumentacionin e plotë të obligueshëm nuk do të shqyrtohen më tej.

V. Dokumentacioni përcjellës:

Organizatat si shtojcë mund të dorëzojnë edhe këto dokumente përcjellëse:

- Biografi profesionale të personave profesional që do të angazhohen në realizimin e projektit;
- Listë referimi ose dëshmi (për shembull: kontratë të nënshkruar) për së paku 2 projekte të realizuara në fushën për të cilën aplikojnë;
- Së paku 2 mendime (referenca) nga partnerë ose donatorë për realizimin e projekteve të mëparshme;
- Përkrahje me shkrim nga organizata të tjera dhe/ose institucione për të cilat është planifikuar që të marrin pjesë në realizimin e projektit.

Vlerësimin e propozimeve të arritura për projektet, do ta realizojë Komisioni i formuar nga Kryetari i Qytetit të Shkupit, në bazë të kriterëve vijuese:

KRITERE PËR VLERËSIM	PIKË MAKSIMALE
1. Struktura organizative dhe resurset	40
1.1. Kapaciteti i Organizatës në raport me resurset njerëzore për realizimin e projektit (të punësuarit, vullnetarët aktiv, personat e angazhuar me honorar)	10
1.2. Profesionaliteti i personave që marrin pjesë në realizimin e projektit	10
1.3. Përvoja e Organizatës në realizimin e projekteve të këtij volumi në fushën përkatëse	10
1.4. Mundësitë hapësinore dhe teknike të Organizatës për realizimin e	5

projektit	
1.5. Aftësia për udhëheqje me buxhetin (a e tejkalon vlerën e projektit buxheti vjetor i shoqatës civile dhe fondacionit për vitin e fundit kalendarik)	5
2. Kualiteti i projektit	60
2.1. Sa do të kontribuojë qëllimi i përgjithshëm i projektit për realizimin e prioriteteve të caktuara, sa është i qartë, i realizueshëm dhe i përcaktuar në mënyrë adekuate	10
2.2. Harmonizim me qëllimet, aktivitetet dhe vlerat e Programit dhe Strategjive të Qytetit të Shkupit	10
2.3. Zgjidhjet e ofruara cilësore dhe inovative për realizimin e qëllimeve programore	10
2.4. Aktivitetet programore të përgatitura në mënyrë të detajuar	10
2.5. Vlerësimi i arsyeshmërisë së shpenzimeve të propozim planit financiar (buxhet real krahas aktiviteteve dhe numrit të personave të angazhuar, përshkrimi i shpenzimeve sipas pozicioneve dhe sa të njëjtat korenspondojnë me çmimet e tregut)	10
2.6. Vlerësimi për pjesëmarrjen në organizimin e Projektit të paraparë me mjete financiare të siguruara nga burimet individuale dhe burimet tjera (për pjesëmarrje individuale prej 15%, aplikuesi fiton maksimum 10 pikë)	10
Numri maksimal i përgjithshëm i pikëve	100

VI. Afati dhe mënyra e dorëzimit të fletëparaqitjeve

Afati i fundit për dorëzimin e fletëparaqitjeve është deri më 23.02.2022, deri në orën 15:00.

Fletëparaqitjet me dokumentacionin e plotë dorëzohen përmes postës në adresën: **Qyteti i Shkupit, Seksioni për mbrojtje sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore, bul. “Ilindenska” nr. 82 1000 Shkup**, ose në arkivin e Qytetit të Shkupit (me emërtim - Seksioni për mbrojtje sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore – Fletëparaqitje për shpallje publike). **Fletëparaqitjet e dërguara me e-mail ose faks nuk do të shqyrtohen.**

Fletëparaqitja për përkrahje financiare të Organizatave, si dhe Formulari për propozim – projekt mund të merren në ueb faqen e internetit të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk.

Pjesëmarrësit në Thirrjen publike do të informohen për rezultatet në një afat kohor prej 15 ditësh nga dita e sjelljes së Vendimit për shpërndarjen e mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2022.

Vërejtje: Fletëparaqitjet me dokumentacion të pakompletuar ose të dorëzuara pas skadimit të afatit të parashikuar nuk do të shqyrtohen! Shtojcat e dorëzuara nuk kthehen.

Për informacione plotësuese:

Pyetje lidhur me sqarime plotësuese mund të parashtrohen në formë të shkruar ose nëpërmjet formës elektronike deri te Seksioni për mbrojtje sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore.

Kontakti: Seksioni për mbrojtje sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore, tel: 02/ 3297 321; E-mail adresa: natasam@skopje.gov.mk.

